



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1252

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Dreni Pharm kundër Njoftimitin e kontratës ose me dokumentet e tenderit të Ministria e Shendetesisenë cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me barna nga LBE per KPSH – Lot 26 me numër të prokurimit:206-25-8077-1-1-1, me 16/02/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE Dreni Pharmme nr. 2025/1252, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me barna nga LBE per KPSH – Lot 26me numër të prokurimit 206-25-8077-1-1-1, ndërsa (AK) - Ministria e Shendetesise në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

2. Mbetet në fuqi vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në pikën I të këtij dispozitivi.

2.Kthehen tarifa e paguar me rastin e parshtrimit të kësaj ankese për OE Dreni Pharm.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Shendetesise në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me barna nga LBE per KPSH – Lot 26me numër të prokurimit: 206-25-8077-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës furnizim.

Me08.12.2025 OE Dreni Pharmka parashtuar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK.

OSHP ka pranuar ankesën nga OE Dreni Pharm nr. 1252/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me barna nga LBE per KPSH – Lot 26 me numër të prokurimit 206-25-8077-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtuar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Dreni Pharm janë parashtuar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit dhe Listës së Barnave Esenciale (LBE) për Lot 26 – *Methylprednisolone Injeksion 40 mg/ml*, ku është kërkuar shprehimisht forma: **flakon 1 ml monodozë dhe flakon 5 ml multidose (500 mg)**.

Sipas OE ankues, OE i shpallur fitues ka ofertuar produktin **Methylprednisolone sodium succinate 40 mg/ml në flakon 2 ml monodozë**, i cili nuk përputhet me kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe në LBE, duke devijuar nga forma dhe vëllimi i kërkuar i paketimit.

OE ankues thekson se elementi i vëllimit të flakonit është pjesë përbërëse dhe thelbësore e specifikimit teknik dhe se ndryshimi i tij përbën mospërputhje materiale me kërkesat e tenderit.

Po ashtu, OE ankues kundërshton arsyetimin e AK-së se substanca aktive mbetet e njëjtë pavarësisht formës së paketimit, duke argumentuar se kombinimi me lidokainë dhe ndryshimi i tretësit nuk është i rekomanduar klinikisht si praktikë standarde dhe nuk është i paraparë në specifikimin e LBE-së.

Në këtë kontekst, OE ankues pretendon se AK ka interpretuar në mënyrë të gabuar dhe formaliste kërkesat e LBE-së, ka pranuar ofertë jopërputhëse teknikisht dhe ka shkelur parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi ankimor nr. 2

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka ndryshuar dhe zgjeruar arsyetimin e vendimit duke shtuar argumente të reja që nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit fillestar të ofertave.

Sipas OE ankues, AK ka arsyetuar refuzimin me faktin se oferta fituese ka qenë më e lirë për 39,200.00 €, se autorizimi i marketingut i dorëzuar nga OE ankues nuk ka qenë i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i AKPP-së, se përshkrimi i produktit nuk ka pasur veçori dalluese krahasuar me ofertat e tjera, si dhe se OE i rekomanduar ka realizuar më parë kontratë me të njëjtin produkt pa ankesa.

OE ankues vlerëson se këto arsytetime përbëjnë tejkalim të kompetencave të AK-së dhe cenim të procesit të vlerësimit, duke e konsideruar vendimin subjektiv, të njëanshëm dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë në trajtim, konkurrencës së ndershme dhe llogaridhënies të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi ankimor nr. 3

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka shtuar arsytetime të reja në vendimin e tij, duke u mbështetur kryesisht në dallimin e çmimit ndërmjet ofertës fituese (220,000.00 €) dhe ofertës së OE ankues (259,200.00 €).

Sipas OE ankues, ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi AK ka qenë e obliguar të vlerësojë përputhshmërinë e ofertave me kriteret administrative, të përgjegjshmërisë dhe specifikimet teknike gjatë fazës fillestare të vlerësimit, dhe jo të shtojë arsytetime vetëm në fazën e rishqyrtimit.

OE ankues thekson se AK nuk ka kthyer lëndën në rivlerësim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe ka shkelur nenin 56 të LPP-së lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës.

Sipas OE ankues, këto veprime përbëjnë shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë barazinë, transparencën dhe trajtimin e drejtë të operatorëve ekonomikë, duke e bërë procesin e vlerësimit të ofertave të parregullt dhe të paligjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 4

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shtuar arsytetime të reja vetëm në fazën e rishqyrtimit, duke e konsideruar Autorizimin për Marketing të dorëzuar nga OE si të papranueshëm për shkak të mungesës së nënshkrimit nga zyrtari i AKPPM-së.

Sipas OE ankues, kërkesa e Dosjes së Tenderit ka paraparë vetëm dëshmimin e regjistrimit të produktit në AKPPM dhe përputhshmërinë me specifikacionet teknike, kriteret të cilat janë përmbushur plotësisht nga OE përmes autorizimit zyrtar të lëshuar nga AKPPM, që përmban specifikacionet e produktit dhe dëshmon regjistrimin e tij për tregtim në Kosovë.

OE ankues thekson se mungesa e nënshkrimit nuk përbën element thelbësor dhe se refuzimi i ofertës mbi këtë bazë përbën interpretim formalist dhe jo substancial, në kundërshtim me parimet e prokurimit publik.

Pretendimi ankimor nr. 5

OE ankues pretendon se përshkrimi i produktit në Autorizimin për Marketing nuk ka pasur dallime materiale krahasuar me ofertat e tjera dhe se arsyetimi i AK-së për refuzimin e ofertës së tij është i pabazuar.

Sipas OE ankues, elementi i ml i tretësit është element thelbësor për përcaktimin e përqendrimit dhe cilësisë së produktit dhe çdo ndryshim në këtë element ndikon drejtpërdrejt në përputhshmërinë teknike të ofertës.

OE ankues vlerëson se oferta fituese nuk i ka përmbushur specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit, ndërsa oferta e tij është refuzuar në mënyrë të padrejtë përmes interpretimit të gabuar dhe formalist të dokumentacionit, duke cenuar parimet e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë.

Pretendimi ankimor nr.6

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar vendimin e tij duke u mbështetur në faktin se OE i rekomanduar ka realizuar kontratë paraprake me të njëjtin produkt pa pasur ankesa lidhur me dozën dhe specifikat e barit.

Sipas OE ankues, ky arsyetim është i papranueshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe praktikat e mira të prokurimit, pasi vlerësimi i ofertave duhet të bazohet ekskluzivisht në përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe jo në përvojën nga kontratat paraprake.

OE ankues thekson se çdo aktivitet i prokurimit është i pavarur dhe se përvoja nga kontratat e mëparshme nuk mund të përdoret si kriter për justifikimin e përzgjedhjes së ofertës fituese.

Në këtë kontekst, OE ankues vlerëson se AK ka shkelur parimet e objektivitetit, transparencës, barazisë në trajtim dhe konkurrencës së ndershme, si dhe dispozitat e nenit 7 dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos zbatuar procedurën e rregullt të vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave.

Pretendimi ankimor nr.7

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka marrë vendime lidhur me kërkesat për rishqyrtim pa i publikuar dhe pa i proceduar ato në platformën elektronike të prokurimit, në kundërshtim me kërkesat ligjore për transparencë dhe qasje të barabartë në dokumente.

Sipas OE ankues, mungesa e publikimit të kërkesave për rishqyrtim dhe e vendimeve përkatëse në platformë ka pamundësuar informimin e plotë dhe të paanshëm të palëve të interesuara, duke cenuar parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

OE ankues vlerëson se ky veprim përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të funksionimit të platformës elektronike të prokurimit, duke e bërë procesin e prokurimit jo transparent dhe të cenueshëm në aspektin ligjor.

Lidhur me pretendimet e OEDreni Pharmeksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/1252 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues dhe ai teknik kanë analizuar në tërësi dhe me kujdes të gjitha pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankues në ankesën e tij. Për qëllime të qartësisë, koherencës dhe për të shmangur përsëritjet e panevojshme, pretendimet ankimore në këtë raport paraqiten në formë të përmbledhur, duke ruajtur thelbin e secilit pretendim ashtu siç është ngritur nga ankuesi. Pas secilit pretendim të përmbledhur, jepet përgjigjja përkatëse e ekspertit teknik dhe ekspertit shqyrtues.

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr. 1

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit dhe Listës së Barnave Esenciale (LBE) për Lot 26 – *Methylprednisolone Injeksion 40 mg/ml*, ku është kërkuar shprehimisht forma: **flakon 1 ml monodozë dhe flakon 5 ml multidose (500 mg)**.

Sipas OE ankues, OE i shpallur fitues ka ofertuar produktin **Methylprednisolone sodium succinate 40 mg/ml në flakon 2 ml monodozë**, i cili nuk përputhet me kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe në LBE, duke devijuar nga forma dhe vëllimi i kërkuar i paketimit.

OE ankues thekson se elementi i vëllimit të flakonit është pjesë përbërëse dhe thelbësore e specifikimit teknik dhe se ndryshimi i tij përbën mospërputhje materiale me kërkesat e tenderit.

Po ashtu, OE ankues kundërshton arsyetimin e AK-së se substanca aktive mbetet e njëjtë pavarësisht formës së paketimit, duke argumentuar se kombinimi me lidokainë dhe ndryshimi i tretësit nuk është i rekomanduar klinikisht si praktikë standarde dhe nuk është i paraparë në specifikimin e LBE-së.

Në këtë kontekst, OE ankues pretendon se AK ka interpretuar në mënyrë të gabuar dhe formaliste kërkesat e LBE-së, ka pranuar ofertë jopërputhëse teknikisht dhe ka shkelur parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Në cilësinë e ekspertes teknike pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vlerësimit profesional farmaceutik dhe klinik, paraqes opinionin si në vijim:

Kërkesa e AK për Lot 26 është Methylprednisolone Injeksion: 40 mg/ mL (si sukcinat natriumi) në flakon 1 mL monodozë dhe flakona 5- mL multi- dozë; 500 mg sipas (Listës së Barnave Esenciale) LBE.

Ndërsa operatori ankues Dreni Pharm në Certifikatën AM e ka Methylprednisone Sodium Succinate Powder and Solvent for Solution for Injection, 40mg 1 Vial with powder + 1 ampoules with solvent in carton box.

Po ashtu OE fitues i Lot. 26 në Certifikatën AM e ka Methylprednisolone Ciron Powder for Solution for Injection, 40mg carton box with 10 ml glass and solvent, 1 x powder for solution for injection.

Në të dy rastet AM tek OE nuk është i përshkruar vëllimi i tretësit.

Te LBE forma është injeksion ndërsa të dy OE kanë ofertuar me pluhur për injeksion dhe tretës.

AK ka shpallur fitues OE më të favorshëm **ekonomikisht me çmimin më të ulët**, duke u bazuar që pavarësisht vëllimit të tretësit nuk ndryshon substanca aktive prej 40mg, ku edhe është cekur nga vet O.E ankues (**Ndërkohë që substanca aktive dhe përqendrimi përputhen, forma dhe vëllimi i flakonit nuk përputhen me kërkesën e DT/LBE, pasi: është ofertuar flakon 2 ml, ndërsa është kërkuar shprehimisht flakon 1 ml monodozë**)

Efekti është i njëjtë nëse jepet e gjithë doza 40mg.

Bazuar në përvojat e deri tanishme klinike ky produkt është në kontratë qe dy vite në SHSKUK dhe KPSH dhe nuk ka pasur ankesë sa i përket dozës pavarësisht tretësit prej 2ml.

Duke u bazuar nga sqarimet e lartpërmendura eksperti teknik, vlerëson se pretendimi i OE ankues është **i pa bazuar**

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr. 2

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka ndryshuar dhe zgjeruar arsyetimin e vendimit duke shtuar argumente të reja që nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit fillestar të ofertave.

Sipas OE ankues, AK ka arsyetuar refuzimin me faktin se oferta fituese ka qenë më e lirë për 39,200.00 €, se autorizimi i marketingut i dorëzuar nga OE ankues nuk ka qenë i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i AKPP-së, se përshkrimi i produktit nuk ka pasur veçori dalluese krahasuar me ofertat e tjera, si dhe se OE i rekomanduar ka realizuar më parë kontratë me të njëjtin produkt pa ankesa.

OE ankues vlerëson se këto arsyeime përbëjnë tejkalim të kompetencave të AK-së dhe cenim të procesit të vlerësimit, duke e konsideruar vendimin subjektiv, të njëanshëm dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë në trajtim, konkurrencës së ndershme dhe llogaridhënies të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK), pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim duke shtuar arsyeime të reja, të cilat nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit fillestar të ofertave, duke cenuar parimet themelore të prokurimit publik.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky pretendim është i bazuar, për arsye si vijon:

Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, oferta e OE ankues është vlerësuar nga AK si e **përgjegjshme**, dhe nuk janë konstatuar mangësi lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, përfshirë edhe **Autorizimin e Marketingut (AM)**. OE ankues nuk është rekomanduar për dhënie të kontratës **vetëm për shkak se oferta e tij nuk ka qenë me çmimin më të ulët** për këtë lot, krahasuar me ofertën e OE të rekomanduar.

Vetëm pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, AK, në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ka ngritur për herë të parë çështjen e vlefshmërisë së Autorizimit të Marketingut, duke pretenduar mungesë nënshkrimi. Ekspertja shqyrtuese vlerëson se një veprim i tillë përbën **ndryshim të arsytimit pas përfundimit të fazës së vlerësimit**, i cili nuk është i lejuar, pasi AK nuk mund të kontestojë apo rishqyrtojë elemente të ofertës që i ka pranuar më herët si të rregullta dhe të përgjegjshme.

Për rrjedhojë, çështja e ngritur nga AK lidhur me AM-në **nuk mund të shërbejë si bazë e vlefshme për justifikimin e vendimit të AK-së**, pasi nuk ka qenë pjesë e vlerësimit fillestar dhe nuk ka ndikuar në klasifikimin e ofertës së OE ankues si të përgjegjshme. Andaj ,bazuar në sa më sipër, **pretendimi ankimor nr. 2 vlerësohet i bazuar.**

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr. 3

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka shtuar arsytetime të reja në vendimin e tij, duke u mbështetur kryesisht në dallimin e çmimit ndërmjet ofertës fituese (220,000.00 €) dhe ofertës së OE ankues (259,200.00 €).

Sipas OE ankues, ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi AK ka qenë e obliguar të vlerësojë përputhshmërinë e ofertave me kriteret administrative, të përgjegjshmërisë dhe specifikimet teknike gjatë fazës fillestare të vlerësimit, dhe jo të shtojë arsytetime vetëm në fazën e rishqyrtimit.

OE ankues thekson se AK nuk ka kthyer lëndën në rivlerësim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe ka shkelur nenin 56 të LPP-së lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës.

Sipas OE ankues, këto veprime përbëjnë shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë barazinë, transparencën dhe trajtimin e drejtë të operatorëve ekonomikë, duke e bërë procesin e vlerësimit të ofertave të parregullt dhe të paligjshëm.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 3

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK), në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ka shtuar arsytetime të reja që nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit fillestar të ofertave, duke u mbështetur në elementin e çmimit për të justifikuar refuzimin e kërkesës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, përfshirë Raportin e Vlerësimit, Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky pretendim është i bazuar.

Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se oferta e OE ankues është vlerësuar si e përgjegjshme dhe nuk është rekomanduar për dhënie të kontratës vetëm për shkak se nuk ka qenë me çmimin më të ulët. Vetëm pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka shtuar për herë të parë arsyetim shtesë lidhur me çmimin, i cili nuk ka qenë pjesë e vlerësimit fillestar.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se shtimi i arsytimeve pas përfundimit të fazës së vlerësimit nuk është i lejuar dhe bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë së trajtimit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Andaj ,bazuar në sa më sipër, **pretendimi ankimor nr. 3 vlerësohet i bazuar.**

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr. 4

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shtuar arsytetime të reja vetëm në fazën e rishqyrtimit, duke e konsideruar Autorizimin për Marketing të dorëzuar nga OE si të papranueshëm për shkak të mungesës së nënshkrimit nga zyrtari i AKPPM-së.

Sipas OE ankues, kërkesa e Dosjes së Tenderit ka paraparë vetëm dëshmimin e regjistrimit të produktit në AKPPM dhe përputhshmërinë me specifikacionet teknike, kritere të cilat janë përmbushur plotësisht nga OE përmes autorizimit zyrtar të lëshuar nga AKPPM, që përmban specifikacionet e produktit dhe dëshmon regjistrimin e tij për tregtim në Kosovë.

OE ankues thekson se mungesa e nënshkrimit nuk përbën element thelbësor dhe se refuzimi i ofertës mbi këtë bazë përbën interpretim formalist dhe jo substancial, në kundërshtim me parimet e prokurimit publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 4

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK), vetëm pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, në vendimin e tij ka shtuar arsytim të ri, duke e konsideruar të papranueshëm Autorizimin për Marketing (AM) për shkak të mungesës së nënshkrimit, ndonëse një kërkesë e tillë nuk ka qenë e paraparë në Dosjen e Tenderit.

Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, Raportit të Vlerësimit dhe Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky pretendim është i bazuar.

Nga përmbajtja e Kërkesës 2 dhe Dëshmisë 2 rezulton se AK ka kërkuar dëshmimin e regjistrimit të produktit nga AKPPM përmes Autorizimit për Marketing në Kosovë, me specifikacionin e produktit të kërkuar, pa përcaktuar asnjë kërkesë lidhur me formën apo nënshkrimin e dokumentit. OE ankues ka dorëzuar Autorizimin për Marketing të lëshuar nga AKPPM, i cili përmban specifikacionin e produktit të kërkuar dhe dëshmon regjistrimin e tij në Kosovë.

Kontestimi i dokumentit për mungesë nënshkrimi është ngritur vetëm në fazën e trajtimit të Kërkesës për Rishqyrtim, ndonëse AK ka pasur mundësi që këtë çështje ta trajtojë gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe, nëse do ta konsideronte të nevojshme, të kryejë verifikimin e dokumentit pranë institucionit lëshues. Një veprim i tillë përbën ndryshim të arsytimit pas përfundimit të fazës së vlerësimit, pasi OE ankues nga vet AK-ja është vlerësuar si i përgjegjshëm. Andaj ,bazuar në sa më sipër, **pretendimi ankimor nr. 4 vlerësohet i bazuar.**

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr. 5

OE ankues pretendon se përshkrimi i produktit në Autorizimin për Marketing nuk ka pasur dallime materiale krahasuar me ofertat e tjera dhe se arsytimi i AK-së për refuzimin e ofertës së tij është i pazuar.

Sipas OE ankues, elementi i ml i tretësit është element thelbësor për përcaktimin e përqendrimit dhe cilësisë së produktit dhe çdo ndryshim në këtë element ndikon drejtpërdrejt në përputhshmërinë teknike të ofertës.

OE ankues vlerëson se oferta fituese nuk i ka përmbushur specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit, ndërsa oferta e tij është refuzuar në mënyrë të padrejtë përmes interpretimit të gabuar dhe formalist të dokumentacionit, duke cenuar parimet e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 5

Pretendimi ankimor nr. 5 është i ndërlidhur drejtpërdrejt me pretendimin ankimor nr. 1, për të cilin është dhënë mendim profesional nga ekspertja teknike. Për rrjedhojë, për arsyet dhe konstatimet e elaboruara në trajtimin e pretendimit ankimor nr. 1, ky pretendim konsiderohet i trajtuar në kuadër të atij pretendimi.

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr.6

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar vendimin e tij duke u mbështetur në faktin se OE i rekomanduar ka realizuar kontratë paraprake me të njëjtin produkt pa pasur ankesa lidhur me dozën dhe specifikat e barit.

Sipas OE ankues, ky arsyetim është i papranueshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe praktikën e mira të prokurimit, pasi vlerësimi i ofertave duhet të bazohet ekskluzivisht në përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe jo në përvojën nga kontratat paraprake.

OE ankues thekson se çdo aktivitet i prokurimit është i pavarur dhe se përvoja nga kontratat e mëparshme nuk mund të përdoret si kriter për justifikimin e përzgjedhjes së ofertës fituese.

Në këtë kontekst, OE ankues vlerëson se AK ka shkelur parimet e objektivitetit, transparencës, barazisë në trajtim dhe konkurrencës së ndershme, si dhe dispozitat e nenit 7 dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos zbatuar procedurën e rregullt të vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 6

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK), vetëm pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, ka shtuar arsyetim të ri duke u mbështetur në referimin në kontrata paraprake të Operatorit Ekonomik të rekomanduar, si bazë për justifikimin e vendimit të tij.

Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, Raportit të Vlerësimit dhe Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky pretendim është i bazuar.

Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Referimi në performancën apo kontratat paraprake të një operatori ekonomik, pa qenë kriter i paraparë në dokumentacionin e tenderit, nuk mund të shërbejë si bazë për pranimin apo refuzimin e ofertës në një procedurë të re prokurimi.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se çdo procedurë e prokurimit është e veçantë dhe e pavarur dhe se mbështetja në kontrata të mëparshme cenon parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme, në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Andaj, bazuar në sa më sipër, **pretendimi ankimor nr. 6 vlerësohet i bazuar.**

Pretendimi ankimor (i përmbledhur) nr.7

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka marrë vendime lidhur me kërkesat për rishqyrtim pa i publikuar dhe pa i proceduar ato në platformën elektronike të prokurimit, në kundërshtim me kërkesat ligjore për transparencë dhe qasje të barabartë në dokumente.

Sipas OE ankues, mungesa e publikimit të kërkesave për rishqyrtim dhe e vendimeve përkatëse në platformë ka pamundësuar informimin e plotë dhe të paanshëm të palëve të interesuara, duke cenuar parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

OE ankues vlerëson se ky veprim përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të funksionimit të platformës elektronike të prokurimit, duke e bërë procesin e prokurimit jo transparent dhe të cenueshëm në aspektin ligjor.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 7

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka publikuar në Platformën Elektronike të Prokurimit kërkesat për rishqyrtim dhe vendimet përkatëse, në kundërshtim me dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky pretendim është i bazuar.

Nga dokumentacioni i lëndës rezulton se AK ka pranuar kërkesa për rishqyrtim dhe ka nxjerrë vendime lidhur me to, por këto dokumente nuk janë publikuar në Platformën Elektronike të Prokurimit si dokumente shtesë, ashtu siç kërkohet shprehimisht nga neni 61.3 dhe neni 63.2 i Rregullores për Prokurimin Publik.

Mospublikimi i këtyre dokumenteve cenon parimin e transparencës dhe pamundëson informimin dhe monitorimin e plotë të procesit nga palët e interesuara, në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik. Andaj ,bazuar në sa më sipër, **pretendimi ankimor nr. 7 vlerësohet i bazuar.**

Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues profesional dhe atij teknik, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara, por e pamajaftueshme për të ndryshuar epilogun e kësaj vendimmarrje.

Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ja fal besimin e plotë raportit të ekspertizës ku është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me barna nga LBE per KPSH – Lot 26 me numër të prokurimit 206-25-8077-1-1-1 dhe si i tillë ky vendim i autoritetit kontraktues mbetet në fuqi.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Ndërmarrja Shëndetsore " Dreni Pharm "**
- Arkivës së OSHP-së: